



Dalës-Izlazno

Nr. 1-71
Br. _____

Data 22.06.2020
Datum _____

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obilić - Municipality Assembly Obilic

Në mbështetje të nenit 43 dhe 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 dhe nenit 47, të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 48.3 të Statutit të Komunës si dhe nenit 21 të Rregullores së punës së Kuvendit thërras:

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës (Legjislatura e VI³⁷, mbledhja e 6) me dt.30.06.2020 (e martë) në ora 10:00, në sallën e Kuvendit komunal me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara
3. Shqyrtimi i kërkesës së Kryetarit të Komunës për ndërrimin e kulturës në parcelën Nr.P-72614055-01842-8
4. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së, për fillimin e procedurës për aktin e themelimit të Bibliotekës komunale (Biblioteka e Qytetit)
5. Shqyrtimi dhe dhënia në diskutim publik e Draft Rregullores për Ndarjen e Titujve të Nderit, Çmimeve, Mirënjohjeve dhe Falenderimeve në Komunën e Obiliqit
6. Shqyrtimi i kërkesës së Komandantit të Policisë në Obiliq
7. Shqyrtimi i KAB-it, për periudhën 2021-2023
8. Shqyrtimi i kërkesës së DAP-së, për lirimimin e ngastrës Nr.01842-1, Z.K.Obiliq
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme



Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Gërguri
Burim Gërguri



Dalës-Izlečna

Nr. 1-72
Br.

Data 22.06.2020
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.10.06.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Florije Jashari (AAK), Muhamet Mustafa (AAK) Qendresa Dubova (AAK), Enver Gashi (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatmir Bektoshi (LDK), Fatos Kurshumlja, (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Mungoi: Armend Rushiti me leje dhe Aziz Bici pa leje

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Zarife Behluli, drejtoreshë e DEFZH-së, Ganimete Aliu, zyrtare për barazi gjinore, përf.i IZHL-së, Eljesa Terbunja, përf, i degës së Handikos-it në Obiliq

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D I T E

1.Rishikimi i buxhetit për vitin 2020.

Kryesuesi – Fillimisht i njoftoi të pranishmit me kërkesën nga Ministria e financave dhe me kërkesën e Kryetarit të Komunës, për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit komunal.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës i cekur më lartë.

Kryesuesi – Për një sqarim rreth rishikimit të buxhetit fjalën ia dha Kryetarit të Komunës.

Kryetari – Ju e dini se rishikimi i buxhetit është i jashtëzakonshëm për arsye të rrethanave që janë krijuar për shkak të pandemisë dhe në këtë rast të gjitha Komunat, e kanë problemin kryesisht të inkasimi i të hyrave vetanake. Ministria, ka kërkuar që në mënyrë urgjente të bëhet rishikimi i buxhetit dhe ne i kemi shikuar të gjitha mundësitë, që janë për bartje në rishikim. Unë besoj se ua kanë dërguar edhe pse ka qenë koha e shkurtë. Mirëpo, drejtoresha mund të ju japë sqarim detal të rishikimit të buxhetit për vitin 2020.

Zarife Behluli – Në takimin e mbajtur me Ekzekutivin, një pjesë e anëtarëve të Kuvendit jeni dakorduar që ta sjellim materialin në Kuvend për rishikimin e buxhetit dhe nuk janë prekë kategoritë tjera, përveç të investimet kapitale. Te investimet kapitale për vitin 2020, i kemi 4 milion e 883,196 €, te të hyrat vetnake janë 29.785 €, ndërsa mjete të bartura nga viti 2019 në vitin 2020 janë 625,398.39 €, që në total buxhet investime kapitale janë 5 milion e 538,379.39 €. Shpenzim kemi 222,557.77 €, në zotim në Prokurim janë 1milion e 129,419.80 €, ndërsa mjete që ende nuk janë të zotuara janë 4 milion e 186,414.82 €. Ne ua kemi dërguar një tabelë ku keni me bë rishikimin e mjeteve dhe aty e keni edhe sqarimin.

Pastaj, drejtoresha dha sqarim të gjerë rreth projekteve sipas të dhënave të paraqitura në tabelë.

Fatos Kurshumlja – Te vlera prej 20,000 €, te blerja e veturave e kuptova shpjegimin për Bashkësinë Islame, por pyetja ime është sa vetura dhe pyetja tjetër është sa mund ti llogaritim 205,000 €, për eksproprijim.

Lulzim Sadiku – Kësaj radhe, vërtetë rishikimi i buxhetit ka ardhë nga Ministria e financave. Është një veti e keqe sepse shumë herë në këtë rishikim materiali na vjen gjysmak, nuk po mundemi me rishikue, që në njëfarë mënyre Kryetari, duhet me ndërmarrë masa se po bëhet një shkelje reale ndaj anëtarëve të Kuvendit. Kësaj radhe, po e arsyetojmë sepse Ministria ka kërkuar dhe unë e kam lexuar materialin, por sqarimet në material dhe të drejtoreshës janë shumë të ndryshme. Unë isha kundër asaj që të hiqen 20,000 €, dhe të blehet makina sepse më duket se Kryetari në mandatin e parë ka premtuar se unë nuk do të bëjë lluks, se do ta shes edhe makinën që e kam. Kërkoj që nga vlera 20,000 €, 10,000 €, të mbeten për varreza sepse psh Kryetar vetëm në varrezat e fshatit Hamidi, me pasë rastin me shkue edhe unë, e ti apo kushdo nga Komuna, kishte me u ndje keq sepse e kanë mbulue ferrat, ndërsa për bari s'po flas fare. Prandaj, propozoj që 10,000 €, të shkojnë për varreza dhe 10,000 €, për një makinë me dhënë në shërbim. Këto, 20,000 €, që janë ndarë për zgjerim janë shumë.

Kryetari – Fjala është për zërim.

Lulzim Sadiku - Këtu, po shkruan zgjerim dhe ndoshta materiali ka ardhë gjysmak, por unë në analizën time po e japë raportin ashtu qysh ka ardhë si material. Po ashtu, materiali po na vjen edhe gjatë mbledhjes së Kuvendit, që vërtetë nuk po mundemi me analizue që me i dhënë vërejtjet dhe sugjerimet tona. Për bashkëfinancim janë të parapara 200,000 €, dhe për 100,000 €, e kuptova Kryetar që ishte një lajm i mirë që e ke dhënë për mjetet që erdhën si donacion dhe ne do të bashkëfinancojmë. Mirëpo, për 100,000 €, më befasoi fakti se Komuna e Obiliqit, ka nevojë për shtëpi dhe ato nuk janë kryer, do të thotë 100,000 €, kanë tepruar në vitin e kaluar dhe unë gjithnjë jam duke folë sipas materialit që e kam. Pastaj, janë 250,000 €, për hartim të projekteve dhe nëse, nuk gaboje edhe me buxhet për hartim të projekteve i kemi ndarë afër 254,000 €. Tash, unë nuk po e kuptoj këta menaxhera, gjithë këto mjete po i ndajnë për ditë, të paktën me dhënë vërejtje me shkue këtë punë. Kryetar, kërkoj që këto vërejtje, propozime dhe sugjerime që i dashë me i arsyetue edhe pse fillimisht e pashë se materiali ka ardhë i pazbërthyer.

Kryesuesi – Sqaron se materiali zyrtarisht ka ardhë të hënën, kërkesa për rishikim ka ardhë të hënën dhe Ekzekutivi për këtë çështje ka punuar edhe në vikend.

Nazmi Gashi - Unë edhe sikur ta kisha marrë materialin para 5 muajve, nuk kisha ditë se çka po bëhet, por e kam një kërkesë për premtimet, bisedat që i kemi pasë për zhvillimin e projekteve, në biznes, në infrastrukturë dhe ndërtimtari, a do të realizohen në këtë vit. Unë këtu, nuk po shohë një pasqyrë që është bërë ndryshim i projekteve, sepse ne edhe iu kemi premtuar njerëzve vitin e kaluar dhe e kemi lënë për këtë vit.

Muhamet Mustafa – Në rreshtin e 10-të, te infrastruktura drejtoresha e shpjegoi shumë bukur se janë investue prej rregullimit të kanalizimeve 20,000 €, dhe kanë shkue në bashkëfinancim 17,987 €, dhe në eksproprijim 1,103 €. Mendoj se kjo, drejtoreshë është gabim teknik që duhet të përmirësohet sepse nuk është 20,000 €, por 17,987 €.

Kryetari – Ne të enjten në ora 10 të natës, e kemi marrë njoftimin për rishikim të buxhetit. Ne e kemi bërë një reagim shumë të shpejtë dhe është përvjedhë si gabim sepse rishikim të buxhetit nuk ka pa votim të Kuvendit, që është shtye për të mërkurën, pasi që e kemi takue edhe Kryeministrin. Ne si Ekzekutiv të premtën menjëherë e kemi shfrytëzue kohën për me bashkëbisedue, për me i nxjerrë se cilat janë mundësitë edhe pse janë shumë të vogla për ndryshim në buxhet sepse shumica e projekteve, janë në vazhdimësi të përpunimit dhe ende nuk kemi ndonjë ofertë për me bërë rishikimin ashtu si duhet. Është fat i mirë në Komunën e Obiliqit, se shumicën e projekteve kapitale që i kemi janë grand dhe kanë shumë pak impakt të hyrat vetanake te projektet kapitale. Vija e bashkëfinancimit, te eksproprijimi, e dini se janë rrënuar banesat e vjetra dhe janë një pjesë në sheshin “Adem Preniqi” prona private për të cilat Ministria e financave, e ka bërë vlerësimin. Ne jemi bazuar në vlerësimin e Minsitrisë së financave, që është një buxhet dikund rreth 108,000 €, që do të ketë shpronësim në atë zonë duke përfshirë edhe disa baraka. Për juve, është e njohur

Depoja e ushqimit shoqëror që ne po e presim tash, derisa drejtoresha e hapë konton e mirëbesimit që të deponoj mjetet, të cilat janë përcaktuar nga Ministria. Po ashtu, kemi vendosë sa i takon sheshit si projekt që të bëhet edhe adresimi i pjesës së shpronësimit. Pastaj, pjesa tjetër për shpronësim, e dini se te Premiumi i kemi 3 lokale, 1 të emëruar dhe 2 janë të konfirmuara, që janë në proces gjygjësor. Në këtë procedurë sipas ligjeve në fuqi, prapë ne do ta bëjmë një konto të mirëbesimit për ato 2 objekte, dhe kushdo që e fiton kontestin nga kompanitë që janë në procedura gjygjësore, e gëzon të drejtën me marrë këtë buxhet. Po ashtu, janë edhe 6 banesa, që e kemi diskutuar edhe më heret që janë në proces të shpronësimit dhe ne njejtë kemi veprue sepse përveç kompanive licencuese, që janë për vlerësimin e pasurisë është edhe Ministria. Prandaj, ne e kemi shfrytëzue rastin, që mos të shpenzojmë në këtë drejtim dhe kemi kërkuar nga Ministria me i subvencionue. Drejtoria për vlerësim e Ministrisë së financave, e ka bërë vlerësimin, jemi në proces dhe është dikund rreth 200,000 €, pjesa poshtë.

Sa i përket vijës te veturat që pyeti z.Fatos, ne kemi nisë me i renovue në mënyrë sistematike, kemi ndarë një buxhet për renovimin e varrezave dhe tash fatmirësisht është shpallë tenderi në procedurë të Prokurimit. Ne e kemi çmimin e përafërt dhe mbetja që ka qenë në vlerën prej 20,000 €, Bashkësia Islame ka kërkuar 1 veturë më të mirë dhe këtë vlerësone edhe ju. Te bashkëfinancimi, ne në vitin e kaluar të hyrat vetanake i kemi bartë për këtë vit dhe i kemi shpërndarë nëpër kategoritë tjera, sepse ka qenë e papritur për ne dhe kemi menduar se është e mjaftueshme vija e bashkëfinancimit. Mirëpo, ju e dini se në javën e kaluar e nënshkruam një memorandum për një park në Mazgit, që shpresoj edhe pjesa tjetër e Obiliqit kanë me frekventue më shumë. Nëse, nuk gaboju projektin është dikund 277,000 €, ose 267,000 €, ndërsa pjesa tjetër mbetet me investue. Ju e dini se ne me buxhet i kemi ndarë 100,000 €, për rastet sociale për shtëpi renovim dhe na u krijua mundësia e re që e nënshkruam memorandumin me Shoqatën “Jetimët e Ballkanit” dhe ato 100,000 €, i kemi bartë në bashkëfinancim. Këtu, u përmendë makina, por kjo makinë në treg nuk i bën më shumë se 7-8,000 €, dhe ne po mundohemi me i krye obligimet me këto, ndërsa pjesa tjetër që është planifikuar me buxhet për makina, shpresoj se është e domosdoshme ti ketë Komuna për me i realizue projektet e veta. Sa i përket pyetjes së z.Nazmi Gashi, unë thashë se fatmirësisht ne projektet kapitale i kemi pothuajse të gjitha me grand, vetëm a mundemi në afate kohore me i përfundue sepse ju e dini se për shkak të pandemisë në maj, është krijuar mundësia e fillimit të punimeve.

Kryesuesi – Te veturat, edhe unë ndoshta isha skeptik në fillim kur erdhën qytetarët te drejtoresha para 2 dite, por pasi që është për Bashkësinë Islame, që është prej rregullimit të varrezave dhe kjo mbetje po shkon te Bashkësia Islame, ia vlen me pasë një shërbim të tillë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 15 vota për dhe 4 vota kundër e miratuan Vendimin për Transferin dhe Ri-alokimin e mjeteve me Rishikimin e Buxhetit për vitin 2020.

Mbledhja përfundoi në ora 10:46

Bashk.prof.për punë të KK

Azize Zenel



Kryesuesi i Kuvendit komunal

Burim Gërguri



Dalës-lizozna

Nr. 1-73
Br.

Data 22.06.2020
Datum

OBILIQ-OBILIĆ



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obilic

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Kuvendit komunal, të mbajtur me dt.29.05.2020, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin këta anëtarë: Burim Gërguri (AAK), Labinot Mirena (AAK), Florije Jashari (AAK), Muhamet Mustafa (AAK) Qendresa Dubova (AAK), Enver Gashi (AAK), Shaip Paloja (LDK), Fatmir Bektoshi (LDK), Fatos Kurshumlja, (LDK), Linda Sadiku (LDK), Arbnore Nasufi (LDK), Hysni Mjeku (PDK), Lulzim Sadiku (PDK), Samire Berisha (PDK), Aziz Bici (LVV), Xhezide Dragusha, (LVV), Nora Preniqi (LB), Armend Rushiti (LB), Nazmi Gashi (Nisma), Slavisa Spasic (SL) dhe Dragan Dancetovic (SL).

Të pranishmit tjerë: Xhafer Gashi, Kryetar i Komunës, Ibush Mjekiqi, Nënkyetar i Komunës, Slavisa Jakovljevic, Nënkyetar për komunitete, drejtorët komunal, Sherif Hoti, menaxher i Prokurimit, Haki Jashari, drejtor i QKMF-së, dhe përf. e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Burim Gërguri, kryesues i Kuvendit komunal i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

R E N D D I T E

1. Arsyetimi për mungesë
2. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Raportit 3 mujor financiar i DEFZH-së
4. Shqyrtimi i Raportit të DSHMS-së, menaxhimi i situatës me pandeminë (Covid 2019)
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Kryetarit të Komunës për vitin 2019
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Kryesuesi – Fillimisht i ftoi të pranishmit për një minutë heshtje në shenjë të viktimave të pandemisë Covid 19.

Pastaj, i njoftoi të pranishmit me rendin e ditës.

Aziz Bici – Te pika e 4 e rendit të ditës, duhet të bëhet një korrigjim, është fjala te menaxhimi i situatës me pandeminë Covid 2019, dhe duhet të jetë menxhimi i gjendjes emergjente Covid 19, e jo Covid 2019. Unë kur thashë gjendje emergjente, mendoj se të gjitha vendimet shumë emergjente ju kanë referuar masave të Institutit të mjekësisë dhe kur thuhet vetëm situatë e pandemisë, do të thotë se nuk është konform me vendimet e Institutit të mjekësisë.

Fatos Kurshumlja – Dua ti falenderoj qytetarët e Obiliqit, për një pjekuri shumë të madhe gjatë gjendjes që e kanë pasë me Covid 19. Propozoj që të futet si pikë e rendit të ditës lirimi i bizneseve lokale nga taksa

vjetore komunale, me përjashtim të disa ndërmarrjeve publike për të cilat zyrtarja ligjore do të na kishte sqaruar.

Kryesuesi – Këtë çështje do ta diskutojmë në pikën “Të ndryshme”.

Aprovohet njëzërit rendi i ditës me vërejtjen e cekur më lartë.

Pika e 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika e 2 e rendit të ditës

Aprovohet njëzërit ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar pa vërejtje.

Pika e 3 e rendit të ditës

Zarife Behluli – Ne i kemi 5 kategori ekonomike të buxhetuara për vitin 2020 dhe atë:

Paga dhe Mëditje janë 4 milion e 78,259 €, alokimi janar – mars është 996,751 €, ndërsa shpenzimi është e njejta vlerë. Mallra dhe shërbime, planifikimi është 823,930 €, alokimi janar – mars është 333,925 €, të shpenzuara janë 83,259.34 €. Te kategoria e shpenzimeve komunale, planifikimi është 316,675 €, alokimi janar – mars është 143,905.50 €, dhe të shpenzuara janë 36,421.90 €. Subvencione dhe transfere, planifikim janë 762,800 €, alokim 112,000 €, këto i kemi me të hyra vetanake dhe të shpenzuara janë 16,217 €. Investime kapitale, 4 milion e 912,981 €, alokimi është 2 milion e 443,1598€, dhe të shpenzuara nuk kemi në 3 mujorin e parë. Total shpenzimi është 1 milion e 132,650.42 €.Të hyrat vetanake kemi arritë ti realizojmë janar - mars 130,793 €. Ne kemi pasë telashe me inkasimin e të hyrave vetanake për shkak të gjendjes së pandemisë dhe i keni raportet për secilën kategori veç e veç.

Kryesuesi – Ju e dini se raporti financiar është vetëm obligim ligjor që njoftohemi me gjendjen financiare, por nuk votohet.

Pika e 4 e rendit të ditës

Kryetari - Të gjithë e kemi përcjellë me shqetësim këtë situatë në të cilën aktualisht gjendemi. Ju e dini që nga dita e parë kur e kemi marrë vendimin e parë nga Qeveria, ne me urgjencë iu kemi përshtatë situatës në të cilën jemi. Ne kemi krijuar shtabin emergjentë në të cilin janë përfshirë drejtorët, po ashtu edhe nga shoqëria civile, Kryqi i Kuq dhe Këshilli i Bashkësisë Islame. Fillimisht i kemi marrë të gjitha rekomandimet dhe jemi munduar ti shpërndajmë përmes portaleve dhe medimeve të ndryshme. Një falenderim i veçantë gjatë gjithë kësaj pandemie që e kemi pasë ju shkon qytetarëve të Komunës tonë, që në masë të madhe është respektue çdo vendim edhe nga Qeveria dhe Ministria e shëndetësisë. Ne si Ekzekutiv dhe qytetarët tonë jemi shumë mirënjohës sepse Komuna jonë ka ndërhy e para me Kuvendin komunal, në situatën shumë alarmante, e ka organizue takimin e parë të mbledhjes emergjente dhe krahas mjeteve, që ju i kemi dedikue ne jemi munduar maksimalisht me i shfrytëzue për këtë qëllim. Unë i falenderoj shumë një pjesë të bizneseve që kanë kontribuar në forma të ndryshme dhe për të evituar rrezikun e mundshëm, ne ndihmat secilit që ka pasë nevojë iu kemi shpërndarë nëpër shtëpitë e tyre. Komuna jonë deri më tani mbi 4,200 pako ushqimore, higjienike i ka shpërndarë për familjet që janë pjesë e skemës sociale, por edhe për familjet tjera, që në pamundësi të zhvillimit të aktivitetit të tyre të punës kanë pasë nevojë me iu ndihmue. Ne kemi reduktuar stafin, kemi bërë dezinfektimin e objekteve, janë bërë edhe aktivitete tjera, siç e dini ka ardhë një mërgimtare nga Londra e Komunës tonë, me të fejuarin e vet të cilët janë vendosë dhe janë marrë të gjitha masat deri në shërimin e tyre. Ekipet mjekësore në terren janë munduar ti identifikojnë nëse, ndonjë qytetar mund të ketë simptome të ngjajshme të përshkruara si pandemia Covid 19. Po ashtu, edhe policia ka luajtur një rol të jashtëzakonshëm të cilët në vazhdimësi kanë qenë të kordinuar me shtabin dhe QKMF-në. Në ndërkohë e dini se e kemi edhe një punëtor të prekur me Covid 19, në Llazarevë, por fatmirësisht nuk është bartë virusi te familjet e tyre. Një pjesë e zyrtarëve dhe anëtarëve të Kuvendit që janë marrë me shpërndarjen e ndihmave, ia vlen të falenderohen dhe bizneset që kanë ndihmuar në këtë drejtim.

Kryesuesi - Unë i falenderoj mantilbardhët të cilët kanë kontribuar shumë në gjendjen e pandemisë, falenderoj Policinë dhe po ashtu Kryetarin e Komunës, që bashkë me DSHMS-në dhe QKMF-në, kanë qenë 24 orë në shërbim të qytetarëve.

Lulzim Sadiku – Dua ta bëjë një falenderim të veçantë për mjekët në Komunën e Obiliqit, shtabin emergjentë dhe Kryetarin, kompaninë “Pastrimi” që ka bërë një punë shumë të madhe, Policinë, Kryqin e Kuq, inspektorët komunal dhe bashkësinë fetare, që ka shpërndarë ndihma. Një falenderim i shkon të gjithë atyre, që kanë punuar për qytetarët e Komunës tonë, por njëkohësisht edhe për shtetin tonë. Unë nuk u pajtova me raportin e drejtoreshës sepse mantilbardhët e Komunës së Obiliqit, 24 orë ishin në shërbim të shtetit dhe ata u gjendën në kufirin ajror, Unë ata i takova në aeroport dhe i takova edhe në kufirin tokësor. Prandaj, mantilbardhët e Komunës së Obiliqit, u panë duke dhënë shërbim për shtetin tonë në kufi që vërtetë jam ndërë i privilegjuar. Unë nuk u pajtova me raportin e drejtoreshës, vetëm në një pikë sepse raporti është shumë i thjeshtë, ndërsa është bërë një punë shumë e madhe. Unë edhe si opozitë aty, ku punohet do ti përgëzoj dhe falenderoj sepse është bërë një punë në mënyrë zinxhimore. Të lumtë, edhe ty Kryetar që e ke udhëheqë në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne si opozitë do të kritikojmë aty, ku është nevoja, por aty ku është mirë do të them se është mirë. Unë nuk pajtohem me raportin e drejtoreshës sepse shërbimi ka punuar shumë, inspektorët kanë punuar shumë, ndërsa është shkruar pak dhe është bërë një raport shumë i thjeshtë.

Enver Gashi – Sot është lehtë me dalë në foltore dhe prej vendit me folë fjalë miradije për një proces që është duke u përfunduar dhe njerëzit tonë e kanë kryer punën me përpikëri të lartë. Prej meje dhe grupit tonë e kanë 10-she, duke u nisë nga DSHMS-ja, QKMF-ja, shtabi, anëtarët e Kuvendit dhe të gjithë pjesëmarrësit në këtë situatë në të cilën ka qenë vendi ynë. Ne jemi Komunë që me të parën e kemi marrë seriozisht këtë situatë dhe sigurisht se rezultati nuk ka munguar. Unë jam inxhinier që flas me numra, i kemi 2 raste dhe ato fatbardhësisht kanë kaluar mirë. Ne edhe si anëtarë të Kuvendit dhe si popullatë duhet të jemi krenar për këtë menaxhim të lartë që e ka bërë së pari shtabi, DSHMS-ja dhe përveç kujdesit shëndetësor ne i kemi parë mantilbardhët tonë në situata të tilla aty, ku e kanë vendin. Sa i përket pagave, besoj se tash Ligji i pagave do të jetësohet.

Qendresa Krasniqi – Unë këtë herë në cilësinë e punëtorit shëndetësor më takon të flas rreth kësaj situatë që është krijuar më parë. Duke falenderuar Kryetarin, Nënkryetarin, drejtoreshën si dhe drejtorin e QKMF-së vërtetë është menaxhuar situata mirë dhe jemi me fat që në Komunën tonë, nuk ka pasur raste përveç 2 rasteve, që janë paraqitur. Kjo, duke ju falenderu qytetarëve të Komunës tonë, të cilët kanë qenë bashkëpunues dhe të respektueshëm, duke i respektuar rregullat që ISHKP-ja, i ka vendosur. Ndërsa, merita më e madhe ju takon kolegëve të mi, gjithë stafit të QKMF-së, të cilët kanë qenë në vijën e parë ku kanë punuar pa ndalë çdo ditë 24 orë. Kjo tregon se sa i rëndësishëm është shëndeti dhe mjekësia, se sa shumë duhet respektuar dhe duhet vlerësuar mjekët, e sidomos Infermierët që punën më të madhe e kryejnë ata. Shpresoj se të gjithë të prekurit nga ky virus të shërohen sa më shpejtë dhe të gjithë ne të vazhdojmë ti respektojmë rregullat e Institutit dhe ti kthehemi normalitetit sa më parë.

Shaip Paloja – Pandemia Covid 19, siç e dijmë të gjithë ka prekë mbarë rruzullin tokësor, e po ashtu edhe shtetin tonë. Fatkeqësisht, ne shprehim keqardhje për të gjitha viktimat në aspektin global dhe në shtetin tonë që kanë ndodhë. Gjithsesi, edhe Komuna jonë është pjesë e kësaj pandemie, që e thanë edhe kolegët para meje dhe duhet të përgëzohen Kryetari i Komunës, shtabi emergjentë për punën e mrekullueshme që e kanë bërë. Shpesh herë mendoj se kanë dalë edhe nga vetveja sepse të gjithë mjekët që kanë punuar e kanë rrezikuar edhe jetën e vet duke iu ofruar shërbim qytetarëve. Po ashtu, duhet përshëndetur edhe stafin e Komunës tonë, në veçanti QKMF-në, e cila ka qenë në nivel të detyrës 24 orë. Të gjithë ata kanë pasë kontakte me pacientë të ndryshëm, që gjithmonë ka qenë potencial i mundshëm i infektimit. Edhe njësisia emergjente, që ka punuar në terren pandërprerë ka merita dhe i përgëzoj për një punë të shkëlqyeshme. Mendoj se shtabi emergjent dhe të gjithë ne duhet të jemi të kujdesshëm sepse prapë jemi në fazën e përfundimit, në mënyrë që e gjithë kjo situatë të përfundoj definitivisht me sukses.

Armend Rushiti – Mendoj se pandemia Covid 19, ka përfshirë tërë botën gjithsesi se ka përfshirë edhe Kosovën, do të thotë nuk ka dalluar asnjëherë komunitet as institucion. Në përgjithësi në Kosovë dhe në Komunë është bërë një menaxhim i duhur dhe për këtë e falenderoj Komunën tonë, shtabin emergjentë dhe

të gjithë të tjerët në veçanti në shëndetësi dhe qytetarët. Unë dua ti falenderoj të gjithë, që e kanë bërë një menaxhim të shkëlqyeshëm të situatës me Covid 19.

Aziz Bici – Kryetar, të përgëzoj për një menaxhim të suksesshëm së bashku me shtabin zgjedhor për këtë pandemi Covid 19, falenderim dhe mirënjohje për të gjithë personelin shëndetësor, Policinë e Kosovës dhe të gjithë ata të cilët kanë dhënë kontributin për menaxhimin e kësaj pandemie. Gjithashtu, edhe qytetarët i përgëzoj të cilët kanë tregue një vetëdije të lartë qytetare sepse pa një vetëdije të tillë nuk do të kishim arritë sukses. Duke iu referuar raportit, po shohë se shumë organizata vendore dhe ndërkombëtare kanë dhënë kontribut me pako ushqimore dhe higjienike, duke mos përjashtuar as bizneset, as mërgimtarët. Edhe njëherë ju falenderoj, suksese Kryetar dhe urime.

Nazmi Gashi – Unë gëzohem që e kemi kaluar këtë krizë, që jemi të gjithë shëndoshë e mirë dhe ky është fati jonë më i madh. Është me rëndësi se njerëzimi nuk është i përgatitur për këto sfida dhe kjo u pa sepse synimet kanë mbërritur me shkue në planetin tjetër, ndërsa ne jemi në telashe në planetin tonë me miliona vjet. Unë kam thënë edhe në Komitet se kjo ka qenë para 1600 vjete, në kohën e pejnigamerëve dhe janë marrë të njejtat dispozita mbrojtëse. E vetmja zgjidhje ka qenë disiplina e vetë qytetarëve dhe fati jonë që nuk na ka sulmue shumë ky virus, përndryshe ka qenë vështirë. Shpresoj dhe besoj se na e ka dhënë një udhëzim të ri, përndryshe duhet me investue në shëndetësi sepse shëndetësia është tregue se është shumë, shumë largë asaj që kërkohet. Fati jonë është se i kemi respektue udhëzimet e shëndetësisë dhe shpëtuam me shpresë se nuk do të përsëritet.

Dragan Dancetovic – Me ne po bashkëjeton pandemia e corona virusit dhe ne edhe më tutje duhet të jemi shumë të kujdesshëm, por edhe ekziston realiteti që prapë të përsëritet. Unë e shfrytëzoj rastin ti falenderoj qytetarët e Komunës tonë, të cilët kanë qenë të përgjegjshëm dhe të disiplinuar në këtë proces, sidomos duhet falenderuar institucionet të cilat kanë qenë të angazhuara në luftimin e kësaj pandemie. Duke iu falenderuar këtyre masave dhe institucioneve, ne nuk kemi ndonjë rast tragjik në Komunën tonë. Nga e gjithë kjo ne duhet ti nxjerrim 2 këshilla, ose rekomandime, që edhe më tutje të jemi të kujdesshëm dhe të disiplinuar. Kjo situatë na ka mësuar se kjo gjendje, kjo pandemi mund ti rrënoj të gjitha resurset si ato njerëzore, ashtu edhe ato materiale. Prandaj, ju falenderoj të gjithëve dhe ju thërrasë që edhe më tutje të jemi të disiplinuar dhe të përgjegjshëm.

Muhamet Mustafa – Edhe unë i bashkohem falenderimeve, për punën e të gjithëve që meritojnë respekt shumë të madh. Unë deshta ta zgjeroj listën e falenderimeve edhe për punëtorët e KEK-ut, për masat që janë marrë, për rezultatet e punës që janë bërë. Mendoj se si institucion edhe ata meritojnë një falenderim të madh në territorin e Komunës tonë dhe masat që janë marrë për mospërhapjen e kësaj pandemie, janë për tu respektuar.

Labinot Mirena – Unë e kam një përshëndetje të veçantë për Fatmirin dhe Hysniun, që ta mbajnë distancën.

Kryetari – Sinqerisht ky sukses nuk do të ishte po të mos ishin edhe anëtarët e Kuvendit, po të mos ishte Ekzekutivi, sidomos qytetarët po të mos i respektonin udhëzimet nga Ministritë dhe Shëndetësia. Mendoj se është një kontribut i përbashkët dhe qëndroj prapë te mendimi se ne ende nuk e kemi përmbyllë si betejë me këtë armik të padukshëm. Pajtohem me atë që tha z.Dragan, se ne duhet të jemi të kujdesshëm, të përcjellim mesazh te qytetarët, që të mundohemi ti kufizojmë lëvizjet tona në vendet publike.

Pika e 5 e rendit të ditës

Kryesuesi – Për një sqarim më detal për raportin vjetor për vitin 2019, fjalën ia dha Kryetarit të Komunës.

Kryetari – Ju e dini se në vitin e kaluar ne për herë të parë e kemi pasë nga buxheti i alokuar për Komunat një ngritje për shkak të tantimës, duke filluar me implementimin e Ligjit të Obiliqit. Dikund kanë qenë mbi 200 projekte, në ekzekutim dhe dua ti falenderoj të gjithë anëtarët e Kuvendit të cilët kanë qenë pjesë e bashkëpunimit në rekomandimin e projekteve, të cilat janë rishikuar në vitin e kaluar. Një pjesë e projekteve janë në ekzekutim, por ka edhe projekte që janë në planifikim dhe ne po vazhdojmë më tutje me punë.

Kryesuesi – Raporti është voluminoz me shumë detyra dhe specifika të ndara, për të gjitha Drejtoritë përgjegjëse. Ndoshta, është një nga raportet më të përpikëta, që padryshim se ka një vlerësim dhe meritë të lartë.

Linda Sadiku – Te raporti i Kryetarit, te Zyra lokale për komunitete vërehet ndërtimi i shtëpive për të kthyerit dhe kjo është shumë diskriminuose për shqiptarët psh në vitin 2019, shihet se janë ndërtuar 14 shtëpi dhe vetëm një është ndërtuar për shqiptarë. Ndërsa, në vitin e ardhshëm parashihen të ndërtohen 12 shtëpi dhe asnjë për shqiptarët, kur dihet se nevoja për ndërtim është e madhe. Unë kërkoj informacion detal pse Komuna jonë pa asnjë kriter lejon kthimin, ardhjen e komuniteteve nga Komunitat tjera, për të jetuar në Plemetin dhe pse pikërisht në Plemetin. Te raporti i Drejtorisë së Arsimit, mendoj se nuk ka vend aq shumë për lëvdata psh te tabela e tretë do ta përmendi vetëm një fakt në nivelin arsimor klasët e X-XII, mbi 65 % të nxënësve është nivel i pamjaftueshëm dhe shihet një numër rekord i mungesave mbi 12,000 mungesa. Te Zyra ligjore, raportohet mbi 32 aktgjykime, 8 prej të cilave janë në favor të palëve paditëse dhe a ka mundësi të dijmë se cilat prej këtyre lëndëve Komuna, i ka humbë në Gjykatë.

Aziz Bici – Unë e kam fjalën rreth realizimit të projekteve për periudhën janar-dhjetor 2019. Fjala, është për përfundimin e projektit të fizibilitetit për kogjenerim, nuk po konsiderohet që është e përfunduar dhe pyetja ime është edhe përgatitja e projektit detal, do të thotë a është në përgatitje apo a është i përfunduar edhe projekti detal për kogjenerim. Te vazhdimi i punës në sheshin e qytetit “Dëshmorët e kombit”, ju e dini se unë vazhdimisht kam kërkuar që të shpejtohet puna se ne jemi të vetëdijshëm që ai nëse, nuk gaboje deri në shtator sipas planit dinamik që ka konkurue ka kohë që vërtetë, mendoj se është dashur ti eliminoj pengesat ndaj Komunes, të cilat kanë qenë deri më sot. Te përfundimi i parkut në Mazgit të Ulët, te lapidari “Ferid Curri”, sot kam shkue dhe e kam vizitue, që në shikim të parë bien në sy 2 pozicione të cilat nuk janë përfunduar si duhet. Në rast se është bërë pranimi teknik i këtij projekti, kërkoj që Komisioni të kërkojë nga kompania e ndërtimit gjithësesi për pozicionin e rrethojës, e cila nuk është me ngjyrë si duhet sepse kishte fillue menjëherë të ndryshket dhe sa i përket gjelbërimit aty, barin e kishin mbulue ferrat.

Lulzim Sadiku – Raporti për vitin 2019, është përshkrim i takimeve në shumë raste, ka gabime drejtëshkrimore, a ka lektor Komuna, apo nuk ka vërtetë nuk di, shikone edhe ju, apo janë bërë gabime për shkak të angazhimeve të shumta që ka qenë pandemia Covid 19. Po ashtu, ka një përshkrim të projekteve të realizuara që përsëriten në drejtimin e infrastrukturës pastaj, te Zyra e Prokurimit që përsëriten në emër të kontratave të përshkrimeve, që vërtetë del një raport shumë voluminoz, që nuk ka pasë nevojë. Ne i dijmë projektet që kanë kalue përmes buxhetit, por njëkohësisht këtu janë përsëritë deri në 3 herë. Te Drejtoria e financave, shtroj pyetje te totali shpenzimet kapitale 625,000 €, a është shpenzim, a është qëllimisht apo është fshehtë sepse nuk e di se a mund të jetë ky suficit. Po ashtu, janë edhe 913,000 €, të shpenzuara suficit nga të hyrat vetanake dhe kjo del se vërtetë është një menaxhim i keq, ose nuk kam ditë ta kuptoj sepse materiali ka qenë bukur i gjerë. Nëse, del kjo se 625,000 €, janë suficit plus 913,000 €, atëherë del 1 milion e gjysmë, do të thotë 30 % e buxhetit nuk është menaxhuar mirë. Besoj se këtu, do të na jepni një sqarim.

Te raporti i Zyres së Prokurimit, pyes si ka mundësi disa projekte janë nënshkruar kontrata qind për qind psh te ndriçimi 60,000 €, të planifikuara dhe 60,000 €, të shpenzuara. Ne e dijmë pak çështjen e Prokurimit, e dijnë edhe tjerët pak, po flas pa qëllime dhe kur e kam lexue materialin më ka nxitë me bë këtë pyetje sepse të shpenzohen mjetet centë për centë, pak është problem. Sa i përket rrugëve për vitin 2019, këtu është cekë se rrugët në Sibofc kanë përfundue, por unë e di se është punuar në fshatin Sibofc, pak më shumë para zgjedhjeve qendrore. Mirëpo, në Sibofc janë 2,3 rrugë që tash janë punuar, është rruga “Hasan Rama” që ka mbetë për afërsisht 200 metra dhe janë 3,4 familje, të cilat kanë mbetë keq. Po ashtu, në lagjen “Sadikaj” asfalti është vetëm deri në dyert e mia, fatkeqësisht kanë mbetë edhe 14 shtëpi, që shpresoj për shkak të buxhetit që e kemi edhe këto do të rregullohen. Te Zyra ligjore, znj. Linda Sadiku që e përmendi dua ti di këto 8 raste që ka humbë Komuna, cilat raste janë dhe sa është vlera e tyre. Te njësia e burimeve njerëzore, vërehet se janë edhe 32 punëtorë të pranuar me kontratë të shërbimeve të veçanta dhe kërkojmë Kryetar që ti ndaloni këto sepse edhe në opinion po flitet se Kryetari për çështje të votave, po i punëson militantët. Kryetar, me këtë të humbë privilegji edhe ty dhe njëkohësisht edhe neve si opozitë, prandaj kërkojmë që ti

ndalosh. Mendoj se është mirë të vijë profesionistët sepse Komuna është e qytetarëve. E kam edhe një kërkesë dytësore, kudo që kalojnë projektet nëpër fshatra të mos bëhen në mënyrë të njëanshme, por është mirë me thirrë edhe opozitën.

Nora Preniqi – Pyeti dhe kërkoi sqarim nga Kryetari për projektet që janë në vazhdim të realizimit të tyre.

Shaip Paloja – Mendoj se pjesë e këtyre projekteve jemi edhe ne si Kuvend komunal sepse buxhetin 2019, me gjithë ato projekte, ne i kemi miratuar. Raporti vërehet mirë se është një raport gjithëpërfshirës dhe janë të përcaktuara saktë se cilat projekte janë të përfunduara, cilat janë në përfundim si dhe cilat nuk kanë filluar fare. Sa i përket Zyrës së Prokurimit, unë e di se për vitin 2019, punët administrative apo tenderimi është përfunduar në mënyrën më rekorde të mundshme, që të arrihet përfundimi i të gjitha projekteve. Mendoj se duhet të përgëzohet Zyra e Prokurimit dhe Ekzekutivi për këto projekte, që pas disa viteve asnjëherë nuk janë realizuar më shumë projekte në interes të qytetarëve tonë. Prandaj, në të ardhmen dëshiroj dhe shpresoj të vazhdohet me projekte, sidomos edhe infrastruktura që mendoj se është në përfundim.

Hysni Mjeku – Unë edhe në Komitet e kam potencue rrugën Obiliq-Palaj-Lajthishtë-Shipitullë-Grabofc, që don meremetim, prandaj pyes lidhur me këtë rrugë se kur do të përfundoj në tërësi.

Kryetari – Fillimisht i përgjegjem znj.Linda Sadiku, se Komuna jonë në vazhdimësi ka qenë pjesë e programit me Ministrinë e kthimit dhe Bashkimit Evropian, për rikthimin e të gjithë atyre që janë banorë të Komunës tonë dhe kanë pronësi në Komunën tonë, që të krijohet mundësia të riatdhesohen. Ne kemi telashe me këtë vendim sepse në të gjitha ligjet potencohet se prona është e shenjtë dhe si duket ka qenë një joshje e njerëzve të cilët i kanë shitë pronat atje, ndoshta me qëllime të përfitimeve të banimit. Po ashtu, ka raste kur i ka lidhë psh edhe miqësia, flas kryesisht për komunitetin rom, ashkali dhe egjiptian, që aty iu është sigurue një tokë. Ne kemi pasë takime të shumta edhe me përfaqësues të fshatit dhe jemi mundue që këtë çështje me adresue në nivelin qëndror. Ne kemi problem edhe me UNHCR-in, që kërkon të paguhet banimi për disa familje që janë në Komunën tonë dhe ne s'kemi pranuar të iu paguajmë qiranë sepse ata nuk janë banorë të Komunës tonë. Ne i kemi 77 banesa, të cilat janë në objektin Hadja 1, Hadja 2, dhe në vitin e kaluar për shkak të zgjedhjeve është dashtë me ndërprerë, pastaj u futëm në dimër që në dimër këto procese zakonisht ndërprehen. Komisionet janë duke punuar dhe i kanë marrë të dhënat e sakta, që shpresoj se në javën e ardhshme do të jepet një vlerësim i saktë. Shpresoj se javën e ardhshme do të nëshkruhet edhe ndërtimi i 20 shtëpive, me bëmirësin tashmë të njohur z.Halil Kastrati, me investimin e tyre në vlerën prej 300,000 €, ndërsa ne 100,000 €, dhe shpresoj se edhe kjo do të realizohet. Pra, janë mbi 100 familje, të cilat do të krijojnë strehim sipas mundësisë së krijuar për familjet, që kanë nevojë. Sa i përket çështjes së aktgjykimeve, janë kryesisht vendime të mëhershme dhe saktësisht nuk di se cilat janë sepse menaxhohen nga Zyra ligjore dhe avokati që është kontraktuar nga Komuna. Nëse, jeni të interesuar ju mund të vini dhe të merrni informacion, por edhe mund të ua sjellim në Kuvend.

Ju e dini se sheshi, ka qenë projekt për 24 muaj dhe e di që pak po lakohet politikisht, uroj dhe kërkoj nga të gjithë ju të bashkohemi sepse vërtetë, është një proces i gjatë. Për zgjidhjen e 24 muajve, kjo ka qenë vetëm nga ne sepse ju e dini se mbi 1 milion është investitor Ministria e infrastrukturës dhe kjo ndikohet pak prej Ministrisë qysh e bëjnë planifikimin e ndarjes buxhetore. Të njejtën situatë e kemi edhe me lagjen “Hadja e Re”, që edhe ky projekt mbi 1 milion e 700,000 €, është i përcaktuar në fazë dhe vazhdon të realizohet. Shpresoj se do ta rregullojmë prapë aktivizimin e negocijimit edhe me postën, nëse do të kemi mundësi me na lirue si objekt nga aty. Pastaj, janë banesat dhe disa lokale për të cilat është bërë vlerësimi nga Drejtoria e Minsitrisë së financave, por raportet kanë ngecë aty sepse ende nuk kanë mund me i adresue te vendet e duhura. Psh te premiumi dhe 2 lokale që janë në atë objekt, janë bërë vlerësimet, por ende AKK-ja nuk ka fillue aktivitetin e tyre dhe Drejtoria e vlerësimit të Ministrisë, të paktën i kanë shkruar qe 2,3 herë. Shpresojmë se nga e hëna do të kompletohen në sistem dhe ti përcjellin vendimet e vlerësimit. Pastaj, pjesa tjetër, ne kemi pasë mundësi ti bëjmë nga marsi, por me rekomandim të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë, të gjitha projektet e ndërtimit dhe rrënimit janë shtye deri me 1 maj. Sa i përket parkut në Mazgit, ne kemi pasë një problem shumë serioz për shkak të papërgjegjësisë së operatorit ekonomik, ne ia kemi ndërprerë kontratën dhe një gjobë të mirë e ka marrë. Ne e kemi bërë praktikë të futen

në listat tona përmes referencave që ato kompani të mos kenë mundësi të aplikojnë në Komunën tonë, është rishpallë dhe besoj se është në proces. Mirëpo, janë edhe disa gjëra që kanë mbetë pa u trajtue duke filluar nga bari, ngjyrosja e rrethojës të fushës, pastaj ulëset, ka problem edhe te ndriçimi. Po ashtu, edhe te pllaka përkujtimore e dëshmorit “Ferid Curri” duhet të hiqet edhe ajo dhe shpresoj se shumë shpejtë do të fillojnë punimet edhe në atë pjesë. Tani, i përgjegjem z.Lulzim Sadiku, gabimet drejtëshkrimore ndodhin dhe ne e kemi pasë një lektor me kontratë mbi veprën, por tash kemi mungesë të stafit dhe duhet me zgjidhë si çështje. Te çështja e buxhetit, e kemi pasë një ngritje enorme te investimet kapitale, te subvencionet që ne bashkarisht kemi bisedue për shfrytëzimin e buxhetit. Shuma që u përmend prej 625,000 €, janë disa nga projektet që janë realizue psh ka qenë 100,000 €, dhe ka ardhë me 50,000 €, kështu që kanë mbetë pjesë tepër, por mirë që janë mjetet e shtetit. Ne kemi pasë 2 procedura njëjërë e kemi pasë në AKM dhe tjetrën në Ministri, që nuk kemi mund me realizue për Rregulloren e subvencionimit të energjisë elektrike, që janë mjete që janë kthyer. Ndërsa, pjesa tjetër janë projekte që i kemi ndalue për shkak të problemeve gjatë ekzekutimit dhe kemi mendue më mirë të rikthehen se sa të bëhen shkelje ligjore. Pjesa e inkasimit, që u përmendë të hyrat vetanake, një pjesë e madhe është në përmbyllje të vitit dhe është një pjesë e madhe te projektet 1 vjeçare. Ne i kemi bartë mjetet te projektet 1 vjeçare, që gjatë realizimit me pasë buxhetin e mjaftueshëm. Te Zyra e Prokurimit, e kemi pasë një telashe se në buxhet te investimet kapitale dhe në fitimet nga projektet e nivelit qëndror në Ministri dhe ju e dini se kemi pasë shumë projekte si sheshi, të lagjes së re, rruga “Hasan Prishtina”, “Isa Buletini”, rruga në Milloshevë ndriçimi me bashkëfinancim, rruga Plemetin-Vushtrri, e shumë projekte tjera. Në njëfarë forme menaxhimi i buxhetit në një start të planifikuar që e kemi pasë një buxhet mbi 4 milion €, në vitin 2015, kemi arritë në një buxhet në vitin 2019, në 12 milion e gjysmë, që ne jemi detyrue me i menaxhue. Punëtorët me kontratë mbi veprën, kjo nuk ka qenë jo ligjore dhe ne kemi bërë kërkesa prapë në Ministri, që nuk ka lëvizje aktuale, por do ta shohim me rishikim të buxhetit. Ato kontrata janë ndërprerë prej fillimit të Ligjit të pagave dhe ne kemi nevojë të jashtëzakonshme edhe për një numër të punëtorëve, por kemi edhe disa punëtorë që janë pensionue dhe ende nuk po mundemi ti plotësojmë vendet. Pastaj, edhe një pjesë kanë qenë të inkuadruar nga Ministria e Mirëqenies dhe Punës Sociale. Tani, i përgjegjem z.Aziz Bici, se ne fillimisht e kemi bërë studimin e fizibilitetit, pastaj është bërë edhe projekti detal. Projekti detal është dikund rreth 38 milion, dikund rreth 80 % të përfshirjes së territorit të Komunës tonë. Ne kemi aplikue në Ministrinë e integrimeve dhe në Bankën Botërore, aty është listimi në 4,5 Komuna me prioritet për çështje të kredisë. Në këtë vit janë ndarë 350,000 €, janë duke e përgatitë fazën e parë të shpalljes së projektit mbi 1 milion €, dhe pritet të fillon si projekt 1 vjeçar. Mirëpo, problemi është te SHF “Pandeli Sotiri” aty është i përcaktuar lokacioni dhe shpresoj se si projekt në vitin tjetër, do të përmbillet.

Tani, i përgjegjem znj.Nora Preniqi, se janë shumë projekte në vazhdim që ndërlidhen me buxhetin që është bartë, dhe të gjitha ato që janë në vazhdim që e thashë edhe më heret duke u nisë nga 1 maji, është një listë bukur e madhe, që po shihet edhe te sheshi që ka ekipe më të koncentruara. Të gjitha rrugët që kanë qenë si projekte, por nganjëherë mund të keqkuptohen edhe emërtimet sepse ne i kemi disa rrugë, ose rrugica të cilat nuk janë të emërtuara për shkak të standardit që përcaktohen për emërtimin e rrugëve, shpeshherë e themi psh rruga “Hasan Prishtina” aneksi 1. Ndoshta, aneksi 1 për shumëkënd është i panjohur se cili është por besoj se për juve që kemi bashkëbisedue janë të qarta. Psh. e kemi rruga “Llapi” dhe tani kemi shumë degëzime dhe ne themi rruga “Llapi” dhe anekset, por mund të ndodhë edhe ndonjë gabim drejtëshkrimor që nuk e kanë potencue aneksin, ose segmentin etj. Rruga Sibofc-Shipitullë-Grabofc, e dini se është projekt i mëhershëm dhe është përfitim nga Ministria e infrastrukturës, është nisë nga Plemetini në Hamidi, pastaj ajo pjesa e Sibofcit atje, është nisë nga Lajthishta deri në kodër të Sibofcit. Ne kemi kërkuar nga drejtori Fatmiri, i cili është duke e përgatitë me paramasë dhe parallogari, që do të shohim me mjete buxhetore dhe besoj se do të vazhdoj deri në Grabofc, kudo aty që është prerë dhe mbushë me zhavorr dhe ato që kanë mbetë janë çështje që do të kryhen në këtë vit. Tash, pse ka ndodhë kjo dhe ndoshta, kanë mund të renovohen të gjitha gropat ju e dini edhe vetë se sivjet ndoshta, është bërë 1 metër e gjysmë por në vitin tjetër e ke 5 metra, ndërsa vitin tjetër e ke edhe më gjatë. Ne sa kemi pasë mundësi me punue kemi punue,

por në total janë edhe 30,000 €, nga Ministria, ndërsa pjesën tjetër e vazhdojmë me mjete tona financiare. Projektet që i kemi pasë në vazhdim janë cënue disa në aspektin buxhetor dhe ne e kemi bërë një ankesë në Komisionin parlamentar për buxhet, pastaj e kemi diskutue edhe nëpër forumet tjera, se është mirë projektet që janë në vazhdim të përmbyllen. Ne e kemi nënshkruar një memorandum me KEK-un dhe me Bankën Botërore, që të fillon parku nacional në Dardhishtë, deri te 01-i, siç e quajmë në territorin tonë, ndërsa janë 80 ha në territorin e Fushë Kosovës. Grupet punuese të ekspertëve janë krijuar të Komunës, dhe të KEK-ut, të Fushë Kosovës dhe Bankës Botërore dhe sa jam i informuar 6-8 milion dollarë, do të jenë në pjesën e Komunës tonë, ndërsa pjesa tjetër do të jetë 25- 30 milion.

Armend Rushiti – Në raportin e punës të Kryetarit për vitin 2019, janë kryer shumë projekte, por kryesisht në lokacione të veçanta, e që kanë përfituar më shumë disa fshatra si psh. Palaj, Lajthishtë, Breznicë, Kozaricë, Raskovë ndërsa edhe fshati Bakshi është në Komunën tonë dhe falë përkrahjes së tyre jeni në pozitën e Kryetarit dhe normalisht ata edhe kërkojnë feedbackun e tyre. Projektet që janë realizuar në fshatin Bakshi, ku shihet në raport janë shumë të pakta dhe kjo është shqetësuese. Nga kryesia e fshatit Bakshi që nga shtatori i vitit 2018, i ke edhe projektet të kërkuara nga banorët ku janë të cekura 15 pika të projektit dhe nga ato shumë pak janë bërë dhe nëse, është nevoja i ceku me rend një nga një cilat janë realizuar, e cilat jo.

Nga projektet janë realizuar:

1. Dy-tri rrugë të shtruara me kocka në gjatësi përafërsisht 150 m.
2. Një rrugë e shtruar me asfalt, vazhdim i rr. "UÇK".
3. Ndriçimi i fshatit
4. Reka e pastruar në fshat është realizuar në këtë vit në mënyrën më të keqe të mundshme dhe me problem.
5. Largimi i mbeturinave tek lumi Llap, e që janë larguar afër lumit mirëpo jo në mënyrë të kënaqshme nga se edhe mundësia e kalimit të banorëve, në anën tjetër të lumit për t'i punuar arat është e pamundur. Ndërsa, pastrimi i mbeturinave te Potoku është përfunduar.

Projektet e tjera, që kanë qenë të rëndësishme, e që nuk janë realizuar janë:

1. Ura mbi lumin Llap
2. Fusha sportive
3. Asfaltimi i rrugës Bakshi-Llazarevë.
4. Asfaltimi i rrugës prapa fshatit "Luftëtarët"
5. Rregullimi me gurë dhe trotuari i përrockës
6. Gjelbërimi përreth rrugës me drunjë dekorativ
7. Ndërtimi i trotuarit për këmbësorët përreth trotuarit.

Këto janë vetëm disa nga projektet e rëndësishme, e që nuk janë realizuar.

Muhamet Mustafa – Pyeti se a ka projekt për ndriçim në rrugën Milloshevë – Obiliq, sepse është një shkëputje te Hashanët te ndriçimi aty, që e ka rregullue KEDS-i.

Kryetari - Përgjegjet se ne planifikimin e kemi bërë 4 vjeçar dhe jemi mundue me i zgjedhë disa rrugë që janë më me prioritet. Mbeturinave ne po i pastrojmë por prapë po mbetet e njejta situatë. Sa i përket projektit të fushës dhe pjesës rekreative, ne kemi nisë si procedurë pastaj ligji ndryshoi dhe tash e kemi prapë në proces. Prandaj, në momentin që fillon Drejtorati i Ministrisë së financave, për vlerësim besoj se në këtë vit do të fillon të ekzekutohet. Te shkëputja e ndriçimit, kufizimi i mundësisë buxhetore, ka qenë projekt i bashkëfinancimit me Ministrinë, që është dashur me shkëput prej juve, Raskovë e Bakshi, por prapë është në projekt të këtij viti dhe besoj se është e planifikuar.

Lulzim Sadiku - Unë nuk mora përgjegje për pyetjen që e bëra dhe për 625,000 €, e kuptova por për 913,000 €, të shpenzuara suficit nga të hyrat vetanake nuk mora përgjegje. Te Zyra e Prokurimit, pyes se a ka mundësi të planifikohen 60,000 €, dhe të shpenzohen 60,000 €.

Sherif Hoti – Sqaron se Zyra e Prokurimit për vitin 2019, ka nënshkruar gjithsejt 92 kontrata në vlerën mbi 6 milion €. Mirëmbajtja e ndriçimit publik është shërbim dhe është kontratë kornizë 3 vjeçare, që është

procedue me çmim për njësi. Çmimi për njësi mund të del 100 €, po supozoj, por kontrata lidhet me buxhetin e parashikuar 20,000 €, në këtë rast për një vit dhe për 3 vjet 60,000 €.

Kryesuesi – Ju njoftoj, se në javën e ardhshme do ta keni një takim për planin zhvillimor komunal, pastaj bashkarisht do ti vizitohet shumicën e projekteve në çdo vendbanim duke u nisë nga Obiliqi, Lajthishta, Palaj, Sibofc, deri në Grabofc.

Pika e 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Paraqet rekomandimet nga mbledhja e KPF-së, të mbajtur me dt.27.05.2020.

Kryetari - Ju njoftoj se një trafo që e kemi prapa postës, do të zhvendoset te cepi i rrethojës së shkollës “Ismail Dumoshi” që ndan shkollën, që ndan Shtëpinë e kulturës “Xhavit Haziri”.

Kryesuesi - Ju njoftoj se kemi një kërkesë nga MAPL-ja, lidhur me vendimin që e kemi marrë për pagat jubilarë sepse nuk lejohet pagesa nga mallrat dhe shërbimet, por nga pagat dhe meditet. Në vitin e kaluar mjetet janë marrë nga mallrat dhe shërbimet ndërsa, në këtë vit pse ndryshoi kjo çështje na njofton drejtoresha e financave.

Zarife Behluli – Sqaron se në vitin e kaluar kanë qenë të gjithë ata, që kanë dalë në pension ndërsa, për këta që ende nuk kanë dalë në pension ka problem tërë Kosova, me pagesën e pagave jubilarë. Tani, sipas Qarkores buxhetore, te Drejtoria e Arsimit është si masë e pagave për pagat jubilarë, për ata që shkojnë në pension, e jo këta që ende nuk e kanë mbërri kohën e pensionimit.

Kryetari – Sqaron se ne buxhetin e kemi sipas planifikimit që e kemi bërë në Drejtorinë e Arsimit, mirëpo kodin buxhetor ata nuk po e pranojnë dhe ky nuk është vetëm problemi ynë, por i të gjithëve.

Lulzim Sadiku – Unë sa e di javën që shkoi Komuna e Vushtrisë, ua ka dhënë një numri të punëtorëve pagat jubilarë dhe ndoshta, mund të jetë informacioni jo i saktë, por prej një kolegu në Vushtri, ata që i kanë 20 vite punë edhe i kanë marrë 2 paga. Ne kemi marrë vendim që të paguhen pagat jubilarë dhe prapë jemi që të paguhen ata që pensionohen. Mendoj se është mirë të kordinohemi me kryesuesin e Komunës së Vushtrisë sepse ata e kanë një formë, do të thotë edhe ne ta gjejmë formën e duhur për pagesën e pagave jubilarë. Ne jemi pro çdo vendimi, por mos të ngutemi me marrë vendim derisa ta dijmë saktë a ka marrë vendim Komuna e Vushtrisë, apo jo.

Kryetari – Ne buxhetin e kemi, por në muajin e ardhshëm duhet me gjetë një formë qysh po e implementojnë Komunitet tjerë, të veprojmë edhe ne.

Kryesuesi – Në mbledhjen e KPF-së, u ngritë çështja e një numri të pensionerëve, të cilët ende nuk e kanë gëzuar të drejtën e pensionimit dhe e kishin frigën mos po vdesin sepse 2 kishin vdekur, kështu që ne duhet ta gjejmë një formë edhe për ata.

Kryetari – Sqaron se janë disa që kanë bërë padi në Gjykatë dhe iu është kthye një përgjegje, por Drejtoria ka rekomanduar që këta ta tërheqin padinë me qëllim që Drejtoria, të veprojnë ashtu qysh ka vepruar me kolegët e tyre.

Kryesuesi – Ne duhet ta shfuqizojmë këtë vendim ndërsa, në muajin e ardhshëm të marrim vendim të veçantë.

Anëtarët e Kuvendit komunal me 16 vota për e miratuan Vendimin për Shfuqizimin e vendimi nr.-I-32, i dt.28.02.2020, për ndarjen e mjeteve buxhetore për pagesat e obligimeve sipas kontratës kolektive, të datës 18.04.2017 për pagat jubilarë.

Pika e 7 e rendit të ditës

Fatos Kurshumlija – Unë i kam 2 kërkesa, që mbledhjet e radhës të Kuvendit mos ti mbajmë të premtën sepse e kemi kohën e namazit dhe vitin e kaluar kur e kemi bërë projektimin e buxhetit për vitin 2020, kam propozuar rrugën e fshatit Lajthishtë, që e lidhë me fshatin Hamidi. Mirëpo, kur e kemi votuar buxhetin për vitin 2020, ka qenë vetëm shuma për infrastrukturë 300, 000 €, për ndërtimet e rrugëve. Tani, dua të di se a është projekt për vitin 2020 ajo rrugë dhe nëse, merret vendim me u realizue ai projekt kisha dashur nga Drejtoria e infrastrukturës, me pasë një kontakt shumë të mirë me kompaninë e ujësjellësit, që me ndërrue gypin prej shkollës deri te xhamia sepse aty çdoherë pëlçet dhe duhet me pre rrugën për me rregullue.

Kryetari – Meqë, nuk e kemi drejtorin këtu, sinqerisht nuk e di saktë rrugën, por duhet me ia përcjellë me telefon ose në email drejtorit këtë çështje.

Kryesuesi – Sa i përket ditës e premtje, kjo ishte e premtja e parë pas lirimit të masave nga Qeveria e Kosovës dhe ndoshta, edhe unë kam pasë arsye, por ju keni mund të lirohemi dhe të shkonim. Po ashtu, kemi pasë shumë material për këtë mbledhje dhe ne kemi mund ta mbajmë mbledhjen më heret, por kemi dashur me ju dhënë hapësirë juve, që të keni kohë me lexue materialin.

Armend Rushiti – Unë kam një kërkesë nga një anëtar i Bashkësisë Islame, për mirëmbajtjen e varrezave, nevojitet një mjet bager për hapjen e varrit dhe një mjet transportues për bartjen e kufomave. Këto kanë qenë kërkesat nga një anëtar i Bashkësisë Islame në Obiliq.

Kryetari – Përgjegjet se sa i përket mirëmbajtjes së varrezave është në shpallje, në proces se të gjitha varrezat do të mirëmbahen. Ne e kemi pasë një bashkëpunim të vazhdueshëm me Këshillin e Bashkësisë Islame dhe një herë ose dy herë së paku e kemi furnizue me vetura, por për bager nuk ka pasë ndonjë kërkesë dhe ju e dini se shërbimin e hapjes së varrit, ne e kryejmë dhe të gjitha shpenzimet tjera.

Aziz Bici – Ne i pamë përmes televizionit pakënaqësitë e disa banorëve të ndërtesave, a mund të na jepni informacion pak më detal se çka është duke u bërë me ata. Ndërsa, e kam edhe një kërkesë konkrete që më ka telefonue, fjala është për Ismet Bërbatovcin, se atyre banorëve a do të ju bëhet ndonjë zgjidhje, a do të ketë banim apo si qëndron çështja për banimin e tyre.

Kryetari – Përgjegjet se ju e dini se afër një vit e gjysmë jemi marrë si proces në Kuvend, si zonë me interes dhe tani KEK-u, për aprovimin që ia vlen me falenderue për me ardhë deri te përmbyllja e nënshkrimit të Kryeministrit të një vendimi që neve, na u krijua kjo mundësi. Ne e kemi pasë edhe pjesën te Premiumi që ka qenë kontestuese, ka qenë pronë e KEK-ut, posta ka qenë gjysmë KEK, gjysmë Komunë. Pastaj, pjesa kryesore e sheshit “Dëshmorët e kombit” ishte KEK dhe duke vazhduar me pjesën lartë. Ne e kemi marrë si informacion duke respektuar edhe bazën ligjore me bartjen e dokumentacionit në evidentim të gjitha pronat që i kemi marrë nga KEK-u, që janë disa i kemi bartë në kadastër te ne. Pastaj, i kemi paralajmëruar në shkurt banorët dhe restorantin e KEK-ut, me vendime se ato do të rrënohen dhe për shkak të pandemisë në njëfarë forme ne i kemi ndërprerë aktivitetet të gjitha. Mirëpo, nga një maji, kur u krijua mundësia që të vazhdojmë me projekte sipas rekomandimit të Minsitrisë së Shëndetësisë dhe Institutit kombëtar të shëndetësisë, e kemi paralajmëruar restorantin e KEK-ut, që ti heqë rrethojat. Vlera e objektit ka qenë dikund rreth 20,000 €, rrënimi, bartja, transporti i mbeturinave inerte që janë krijuar aty dhe këtë e ka kryer KEK-u, me mirëkuptim. Po ashtu, qytetarët i kemi njoftu dhe në pamundësi me i bartë krejtë në banesat e Hades, ne ua kemi krijuar mundësinë për të gjithë ata që janë raste sociale, e kemi krijuar një Komision i cili do ti trajton në mënyrë të veçantë dhe nga subvencionet e Kryetarit do të iu paguhet qiraja 2 muaj në vlerën prej 150 €. Të gjithë ata, që kanë prona të veta krijohet mundësia të shpronësohen ndërsa, pjesa tjetër duke e veçuar pompën e benzinës, të tjerat janë hapësira të lira. Neve, na vjen keq që z. Ismet ka qëndruar një kohë shumë të gjatë aty, por na vjen mirë që djemtë e z. Ismet kanë një shtëpi, kështu që ai e ka një mundësi ku mund të strehohet. Ne jemi në proces të kontraktimit të një kompanie, që do të merret me renovim të pjesshëm në vitin e ardhshëm dhe do ta kontraktojmë edhe një kompani për shërbime sepse ka banesa që e kanë gjendjen jashtëzakonisht të keqe. Ne do ti ndjekum procedurat ligjore për banesat e braktisura, se si do të arrijmë deri te hapja e tyre, do të jetë Komision i veçantë që do të merret me regjistrimin e gjërave që janë aty, brenda dhe do të rregullohen. Pastaj, atyre që do të ua shpërndajmë banesat do të jenë në gjendje të rregullt, por edhe do të kërkojmë që ta kthejnë në gjendje të rregullt. Të gjithë ata që do ta gëzojnë të drejtën, do të jenë edhe përfitues.

Dragan Dancetovic – Ekzistojnë disa probleme, para 10 dite kanë ndodhë disa vjedhje në fshatin Baimoc dhe fatkeqësisht këto raste po përsëriten prandaj, ju lus si Kryetar që të ndërmermi disa masa konkrete në këtë drejtim. Policia është e pranueshme dhe patrullon gjatë natës, por edhe përkundër prezencës së policisë nuk ka edhe resurse humane sa duhet. Kërkesa jonë është që të

vendosen video kamerat, jo vetëm në fshatin Baimoc, por edhe në lokalitetet tjera. Unë nuk di sa jeni ju i njoftuar, por aty është bërë vjedhja e makinave shumë të rënda bujqësore, të vlefshme. Kjo nënkupton se këtu, është një grup shumë i fortë i organizuar që po i bën këto vjedhje. Problemi i dytë që dua ta theksoj është se ka ndodhë një fatkeqësi natyrore, ka ra breshër në fshatin tonë në javën e kaluar që ka shkaktuar dëme të caktuara, prandaj është e nevojshme që nga Komuna të formohet një Komision i cili do të bëjë vlerësimin e dëmeve në të mbjella, në pemë dhe perime. Po ashtu, janë dëmtuar edhe disa objekte dhe automjete. Sa i përket investimeve, planifikimit të projekteve për këtë vit, kam qenë në grupin punues komunal që kemi qenë në fshatin Baimoc dhe njëri nga prioritetet e tanishme për fshatin Baimoc, është kanalizimi sidmos në pjesën më të ulët në autoudhë. Edhe kemi disa rrugica brenda fshatit ku fatkeqësisht qytetarët kalojnë nëpër rrugë të baltosura. Në vitin e kaluar i kemi konstatuar këto 2 probleme, që kanë qenë premtimet se ato do të realizohen në këtë vit dhe pres që në këtë vit këto probleme të zgjidhen.

Lulzim Sadiku – Për banesat që u folë se pritet të rrëzohen mua, më intereson çështja e Inës, se a Mbetet ish Ina shtetëore në atë pjesë, çka do të bëhet me Inën dhe a kanë filluar procedurat. Pyetja tjetër është te çështja e banesave, mendoj se Komisioni punon sa më shpejtë, sa më mirë, por ndoshta është një e metë Kryetar, që ke lejuar që Komisioni të formohet vetëm nga pozita, sepse është dashur të bashkëpunosh edhe me opozitën, që ka qenë më e drejtë.

Arbnore Nasufi - Unë kam një shqetësim nga banorët e lagjes në Obiliq të vjetër, në anën e majtë janë disa shtëpi të ndërtaura prej paslufte për komunitetin serbë, por janë të pabanuara dhe aty qe një kohë të gjatë kanë filluar të hudhen mbeturinat. Tash, ato janë stërmbushë me mbeturina dhe është shqetësim i banorëve, edhe prej fëmijëve që po luajnë aty si dhe prej qenve endacakë. Unë dua të di se ajo pjesë a është në menaxhim të Komunës, që me bë ndonjë rrethojë aty, që mos me i lënë me hudhë mbeturina afër shtëpive tjera, të cilat janë të banueshme.

Hysni Mjeku – Edhe unë e kam një shqetësim se në muajt e kaluar lumi Drenica, është ndotë jashtëzakonisht shumë sa që ngjyra e lumit ka qenë kafe e mbyllët dhe për çudi as Ministrinë përkatëse në nivel Qeverie, as Drejtoritë komunale tona, nuk kanë reaguar. Unë apeloj që Drejtoria e inspeksionit së paku 2 herë në muaj, ta viziton lumin Drenica dhe të mos ndodhë më një ndotje e tillë enorme. Ne po përkushtohemi me mbrojtë ambientin, ndërsa vërtetë në pikë të ditës po e ndotim. Shqetësimin tjetër e kam për objektin shkollor që shtë prapa neve, pranë shkollës së mesme dhe Komunës, me dritare të thyera, të demoluara para një institucioni komunal. Vërtetë, edhe Kryetari duhet ta dijë se duhet të rregullohet dhe pastrohet, në mënyrë që mos të kemi probleme edhe me nxënës dhe me qytetarë, por edhe me shëndetin e vetë qytetarëve të Komunës. Unë besoj se Kryetari bashkë me Drejtoritë përkatëse, duhet ta gjejë një mundësi për rrënimin e këtij objekti.

Kryetari – I përgjegjem z.Dragan Dancetovic, se ne jemi në komunikim të vazhdueshëm me Policinë dhe siç duket një pjesë të mjeteve bujqësore i kanë gjetë dhe rikthyer, që duhet të falenderohet Policia. Ne para 2 viteve, e kemi nisë një projekt ideor që ka filluar të realizohet në instalimin e kamerave dhe janë instaluar 4, ose 5 kamera, që janë shumë pak, por është fat i mirë që është bërë një studim i komplet territorit. Ne do të vazhdojmë me një projekt që drejtori i DSHPE-së, e ka përgatitë dhe shpresoj se në këtë vit në Komunën tonë do të jenë dikund rreth 50 kamera të këtij projekti dhe sheshit, pastaj do ti shpërndajmë edhe nëpër fshatra. Sa i përket breshërit, drejtori i bujqësisë më ka njoftue se janë duke punuar në këtë drejtim dhe ju e dini se këto pastaj duhet të adresohen në Ministrinë e bujqësisë. Ndërsa, për veturat e dëmtuara nuk e di qysh është e rregulluar këtu, por e di se nëse kanë sigurim nuk marrin përsipër institucionet kompenzimin. Projektet që i kemi diskutue besoj se ato do të jenë në fazën e realizimit dhe të kisha rekomandue që një ditë bashkë me drejtorin e infrastrukturës dhe të shërbimeve publike me dalë dhe me i pa. Tani, i përgjegjem z.Lulzim Sadiku, se ne i kemi marrë masat dhe kemi shkue në AKP, pasi që është në menaxhim të AKP-së, por nuk na doli puna aq lehtë sikurse edhe me objektet tjera, dhe ju e dini se është një shifër e madhe e kostos. Përveç kësaj, këto janë të Kroacisë, që janë në procese gjyqësore sipas informatave që i kemi marrë nga AKP-ja, dhe është në proces me shtetin. Ne mund ta bëjmë

shpronësimin pa asnjë problem, por delë një kosto bukur e madhe. Ne në planin zhvillimor duhet me parapa se në të ardhmen duhet ta heqim nga aty, por duhet me prit momentin ose të bëhet kompensimi nga shteti, apo marrëveshjet qysh do të jenë ndërshtetërore Kroaci-Kosovë, por nuk vlen rregulla e 20 %-it. Psh Premiumi, e ka një vlerë dikund prej 10,000-15,000 €, dhe ne vetëm e paguajmë 20 %-in e saj, ndërsa pompa aktuale meqë është e një shteti tjetër nëse, hyjmë në kompensim të vlerësimit duhet me ia bë qind për qind. Prandaj, ne kemi menduar se në të ardhmen shtetet do të kenë ndonjë marrëveshje në këtë drejtim. Unë kam vendosë me marrë edhe mendimin tuaj, qysh e vlerësoni ju, por duhet me llogaritë se vlera është prej 300,000-500,000 €, qysh po flitet sipas vlerësuesve sepse i kanë pajisjet e shtrenjëta.

Z.Hysni, e përmendi shkollën, znj.Arbnora e përmendi çështjen e mbeturinave dhe në Palaj i kemi disa prona private, që janë njësoj sikur andej nga ju të cilat janë mizerie. Si përket shkollës, ne kemi mendue dhe kemi bisedue me Bashkimin Evropian, që me krijue mundësinë ku është fusha e sportit te ish teknika, të ndërtohet një shkollë për komunitetin serbë dhe presim nga Bashkimi Evropian, që ta përmbyllë këtë projekt. Posta do të hiqet nga aty dhe të pastrohet. Në të ardhmen ne duhet me parapa edhe çështjen e lokaleve me i shpronësue. Te shkolla, që e përmendi z.Hysni ne dojmë me bë një parking tre katësh sepse është shumë e domosdoshme. Stacioni i autobusëve do të ndërtohet te Obiliqi i vjetër. Ju e dini se ne nuk ndikojmë në ndotje në lumin Drenica, por duhet të flasim me Drenasin se mos po vjen nga Feronikli dhe me ia tërheqë Feroniklit vërejtjen, por duhet të bëjmë përpjekje edhe në zonën nga Dardhishta, derisa të bëhet një zgjidhje e përgjithshme edhe për lumin LLap, Sitnica dhe për të gjithë lumenjtë tjerë.

Hysni Mjeku – Pyeti se kur pritët ndriçimi publik për fshatin Grabofc i Epërm.

Kryetari – Përgjegjet se pjesa tejër e ndriçimit është në proces në Zyrën e Prokurimit dhe besoj se do të realizohet në këtë vit.

Fatmir Bekteshi – Propozoj që rr.”Adem Jashari” me shqyrtue për të ardhmen, që së paku me bë rrugë një kahëshe me vendparkingje.

Kryetari – Është fat i mirë që ne kemi 2, ose 3 inxhinjerë të komunikacionit në Komunë dhe e di se drejtori ka punuar në këtë drejtim, por te rrugët kemi me pasë disa ndryshime psh e kemi një objekt te Premiumi, është pjesa që jemi në negocijim për me përmbyllë e sheshit, që do të jetë njëkahore me një shpejtësi minimale dhe ne duhet ta sjellim këtë çështje në Kuvend nëse, ajo rrugë do të jetë funksionale prej orës 8-16. Tash, pjesa e sheshit në momentin kur tërhiqet tregu nga aty, sheshi “Dëshmorët e kombit” do të vazhdon deri te rruga “Vashingtoni” që shkon te banesat e Hades. Pastaj, automjetet e rënda nuk duhet të qarkullojnë në rr.”Vashingtoni”, por do të kalojnë nga rruga e Buviesit. Është fat i mirë që ne kemi mirëkuptim me hekurudhën dhe e kemi mbyllë si proces, dje realisht iu është pague pjesa e fundit sipas marrëveshjes që e kemi pasë dhe shpresoj se shpejtë ajo do të bartet në pronësi të Komunës.

Aziz Bici – Kryesues, prej se ke qenë drejtor, e din se kur është shpallë lëshimi i ndriçimit në rr.”Halit Bici” në momentin kur ndezen dritat mungon rrjeti edhe në televizion dhe në internet që nga viti 2017. Mendoj se këtë çështje duhet me marrë seriozisht sepse shtrohet pyetja pse në momentin kur ndezet drita nuk ka program dhe s’ka internet ndërsa, në momentin kur fiket në mëngjez, atëherë ka program dhe internet.

Kryesuesi – Sqaron se ne kur e kemi bërë ndriçimin në atë kohë të njejtën e kemi bërë në Breznicë, Kozaricë, Sibofc, Hade etj. Ne e kemi shfrytëzue infrastrukturën e KEDS-it, në atë kohë sepse kemi marrë leje ndërtimi për me shfrytëzue për kabllon dhe ndriçim. Ne jemi ardhë në përfundim me kompaninë private se duhet me ndërrue kabllon sepse ai kabëll është ndër më të lirat në treg dhe interferon edhe kamerën me vendosë.

Kryetari - Nëse, jeni dakord në fund të javës së ardhshme, kishte me qenë mirë që bashkarisht ta trajtojmë komplet planin zhvillimor komunal.


Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zenel

Mbledhja përfundoi në ora 13:26



Kryesuesi i Kuvendit komunal


Burim Gërguri